

VENDIM
Nr. 946, datë 28.12.2016

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.955, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE TË
SIGURUAR QË PËRJASHTOHEN NGA PAGESAT E DREJTPËRDREJTA TË
SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, e 41, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 955, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) Personat që përfitojnë pagesën për aftësinë e kufizuar.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Përfshirjen nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme për personat që nuk bëjnë pjesë në kategoritë e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, për trajtimin e sëmundjeve kronike, sipas listës së miratuar me urdhër të ministrit të Shëndetësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama